



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 61/2019

**PËR SHQYRTIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR TË PROJEKTLIGJIT
“PËR TRAJTIMIN FINANCIAR, SUPLEMENTAR TË PUNONJËSVE QË KANË
PUNUAR NË MINIERA, NË NËNTOKË, TË PUNONJËSVE TË INDUSTRIË
SË NAFTËS E TË GAZIT DHE TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR
NË METALURGJI”**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 28 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

II. Shqyrtimi në Komisionin përgjegjës për Ekonominë dhe Financat të bëhet në datën 20/21.5.2019.

III. Amendamentet të dorëzohen në komisionin përgjegjës brenda datës 20.5.2019.

IV. Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë është komision për dhënie mendimi.

V. Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet në datën 23.5.2019.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 16.5.2019